

*Akademik Jusuf Bajraktari
Junik, 10.10.2017*

AKADEMI PËRKUJTIMORE KUSHTUAR DITËLINDJES DHE RINGRITJES SË
PËRMENDORES SË HEROIT EDMOND HOXHA
(10.10.1975-31.1.1997)

*I nderuari kryetar i Komunës së Junikut, z. Agron Kuçi,
Zoti kryetar i Parlamentit të Kosovës – Kadri Veseli,
I nderuari deputet i Parlamentit të Kosovës, z. Daut Haradinaj,
Të nderuar pjesëtarë të familjes Hoxha,
Zonja dhe zotërinj të nderuar,
Familjarë të Dëshmorëve të UÇK-së,
Qytetarë të Junikut, të Rekës së Keqe, të mbarë hapësirës sonë kombëtare,
Të nderuar personalitete, përfaqësuese të Institucioneve të Republikës së Kosovës,*

Edmond Hoxha – Edi jetoi shumë pak, vetëm 21 vjet, tre muaj dhe njëzet ditë. Ai jetoi pak, por vepra dhe vizioni i tij jetësor mbeti si një begati e paçmuar dhe trashëgimi pozitive e cila padyshim meriton të përkujtohet me pietet ndër breza.

Sot, na ka bashkuar emri i njërit ndër djemtë trima e më fisnik i Kosovës së djeshme dhe asaj të sotmes, emër ky i dashur e i çmuar për jetë të jetëve, simbol i sakrificës sublime për lirinë e Kosovës.

Në familjen e Hoxhajve, nga babë Hysniu e nëna Nuri lindën dhe u rritën luftëtarët e lirisë, bijë të denjë të atdheut, njëri i njohur për penë e biseda përmbajtjesore dhe tjetri për pushkë e trimëri: Xhavit dhe Edmond Hoxha, të cilët në historinë tonë moderne lanë vepra e kujtime mbresëlënëse e të pashlyeshme. Ndërsa, sot shtatë motrat e tyre janë krenare për ta dhe japin kontributin e tyre me përkushtim për Kosovën e lirë. Fillet e hapave të veprimtarisë politike të Edit, u transmetuan nga vëllai i tij më i madh, Xhavit i njohur ndër ne me guximin intelektual e i gatshëm që në çdo kohë e në çdo mes të vepronte me elokuencë në interes të bashkimit të të gjitha shtresave që për synim kishin çlirimin e Atdheut nga falanga serbe. Ai bënte pjesë në Lëvizjen Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe të viseve shqiptare në ish-Jugosllavi. Si vëllai më i madh pati ndikim të fortë në formësimin politik e luftarak të Edmondit.

Zonja dhe zotërinj,

Sot Juniku është krenar sepse po e feston ditëlindjen e një hero, e një djali që i dha atij shkëlqimin e humbur ndër vite, në mënyrë që me veprën e tij supreme gëzon gjithë dashurinë dhe respektin e vendasve të tij. Përmendorja e Edmond Hoxhës, që po ringritet sot, do të bëhet **Ora e Kujtimit** të lavdisë dhe frymëzimit patriotik për brezat e sotëm e të nesërm.

Juniku, siç dihet është qendër e vlimeve shoqërore e politike prej ku morën flakë e u përhapën si rreze drite vendimet historike të Kuvendit përfaqësues të të gjitha viseve shqiptare në majin e vitit 1912. Juniku është i njohur me vlera të dëshmuara nga malësoret e Alpeve legjendare, me bukurinë mahnitëse në grykën atraktive të bjeshkëve ndër më të bukurat në hapësirën tonë kombëtare, në të cilën lindën e u rritën burra me zë e reputacion të spikatur në vazhden e historisë. Ky është fshati i djeshëm më i madhi në Kosovë, ndërsa sot një qytezë në gjirin e Alpeve Shqiptare, me një perspektivë të ndritshme ku banorët e tij të vyeshëm do të ndërtojnë ardhmërinë dhe jetën e re për nipat dhe mbesat e tyre. Në këtë ambient të mrekullueshëm kanë jetuar në harmoni të përkryer pjesëtarë të 12 fiseve shqiptare e që mbase është rasti më unik në të gjithë shtratin e gjeografisë kombëtare. Po ky Junik e ka mbajtur me nder epitetin e Gjykatës të njohur si “*Oda e Junikut*” me Avdyl Hoxhën famë madh në krye. Ky dhe pleqnarët tjerë në këtë gjykatë mbështetnin vendimet e tyre në parimet e Ligjit të Lekë Dukagjinit, në interes të ruajtjes së rendit e qetësisë ndër shekuj.

Të gjitha këto elemente e tipare mbresëlënëse padyshim janë gërshetuar përsosmërisht edhe në karakterin e fuqishëm të protagonistit me vlera të veçanta njerëzore e kombëtare të tipizuar në figurën emblematike të Edmond Hoxhës, heroit tonë të dashur.

Auditor i nderuar,

Ringritja e Përmendores ka domethënie të shumëfishtë. Ai do të përçojë mesazhin e vlerave të njëmendta tek gjithsecili qytetarë i Kosovës në këto kohë të leshta të kundërthënies shoqërore e politike, të cilat për fat të keq e kanë molisur e katandisur atë. Të shpresojmë në ditë më të mira të cilat ky popull i urtë pa dyshim i meriton.

Mesazhi që del nga akti heroik i rënies së Edmond Hoxhës, Zahir Pajazitit dhe Hakif Zejnullahut, më 31 janarin e acarët të vitit 1997 simbolizon ringjalljen e shpresës jo vetëm në rezistencën e armatosur të popullit të pamposhtur të Kosovës kundër pushtetit terrorizues e shtypës të Serbisë së Millosheviqit, por edhe sot e për nesër, sa herë të gjendemi në udhëkryqet e kohëve trishtuese. Ata figurativisht përcaktuan bashkimin e fuqishëm të të gjithë patriotëve mbi bazën e unitetit të bijve të të gjitha viseve të Kosovës, në kohët më vendimtare. Ata me veprën e tyre paraqesin aspiratën frymëzuese të lëvizjes së mishëruar me ideale që do të finalizohet me çlirimin përfundimtar të Kosovës. Rënia e tyre heroike paralajmëron dhe jep sinjalin e organizimit të një rezistence guerile e luftarake përballë regjimeve të frymëzuara me çizmen e dhunës ushtarake e policore. Akti i trimërisë dhe i guximit të tyre në përballjen e rrethimit të hekurt, i mbështetur në doktrinën e kurtheve dhelparake e më djallëzore, në Pestovë shënon ngjalljen e frymës luftarake në mbështetje të idealeve të lirisë për Atdheun - Kosovën e tyre të dashur.

Figura dhe emri i Edmond Hoxhës në vitet e pasçlirimit janë përjetësuar nga institucionet kulturore-arsimore dhe institucionet e larta të shtetit të Republikës së Kosovës në shenjë të kujtimit të emrit e të veprës së tij madhështore. Pos shumë vlerësimeve, shpërblimeve e dekorimeve, vepra e tij është nderuar edhe me titullin më të lartë “Heroi i Kosovës”.

Lavdi emrit dhe veprës së Edmond Hoxhës dhe dëshmorëve të tjerë të Kosovës.

Ju faleminderit!